



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

PROÇESVERBAL

Mbledhje e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Ditën e martë, datë **15.01.2026**, ora 10:00 në ambjentet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, u mbajt mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile për vitin 2026. Anëtarë të pranishëm në mbledhje ishin:

Për anëtarët përfaqësues të **institucioneve publike**:

1. Znj. Denada Seferi –Zv/Ministre - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Z. Andi Kananaj – Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
3. Znj. Elona Hoxha- Zv/ Ministre- Ministria e Drejtësisë
4. Z. Guri Lekloti – Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin
5. Znj. Esmeralda Demiraj – Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportet
6. Z. Stavri Lako - Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
7. Znj. Elda Xhumari – Ministria e Mjedisit
8. Znj. Irida Laçi – Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
9. Z. Tedi Dobi - Zv/ Ministër - Ministria e Drejtësisë
10. Znj. Silva Caka – Ministria e Punëve të Brendshme
11. Znj. Merita Xhafaj – Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Për anëtarët përfaqësues **të shoqërisë civile** në Këshill:

1. Z. Vladimir Thano –N/Kryetar i Këshillit
2. Z. Indrit Seferi
3. Z. Ergys Gezka
4. Znj. Fabiola Laço Egro
5. Z. Nensi Dragoti
6. Znj. Eglantina Bardhi
7. Znj. Mirela Koçi
8. Znj. Arta Nikolli
9. Z. Vilson Shehu
10. Znj. Blerta Tuci
11. Znj. Irena Topalli

Përfaqësues nga **AMSHC**:

1. Znj. Andia Ndreka
2. Znj. Irena Kero

Pjesëmarrës **të tjerë**:

1. Znj. Alma Lahe
2. Z. Orges Hysenaj

Axhenda e takimit:

1. Fjala e hapjes, Aprovimi i Rendit të Ditës dhe Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së KKSHC datë 1 Prill 2025. Z. Vladimir Thano (nënkryetar i KKSHC-së);
2. Përditësime mbi zgjedhjet e KKSHC-së dhe prezantimi me anëtarët e rinj të KKSHC-së, Znj. Andia Ndreka (sekretariati Teknik i KKSHC-së);
3. Ngritjen e një grupi pune mbi hartimin e kalendarit të aktiviteteve dhe prioriteve për KKSHC-në (roli dhe funksionet), z. Vladimir Thano;
4. Diskutime mbi procesin e zgjedhjeve për anëtarët e rinj të KKSHC-së (mbarimi i madateve në shkurt 2026), Z. Vladimir Thano;
5. Miratimi i datës pasardhëse të mbledhjes së KKSHC-së;
6. Diskutime.

Znj. Denada Seferi: Miëmëngjes! Mirëseerdhët, në fakt në rradhë të parë unë dua që t'iu kërkoj ndjesë që Ministria Sala e kishte të pamundur për shkak të një emergjence, për arsye objektive të mos ishte pjesë e kësaj tryeze, me gjithë dëshirën e madhe që të ishim bashkë dhe që të gjithë të kishim mundësinë që të diskutonim në këtë Këshill Kombëtar të Shoqërisë Civile, si një mbledhje e parë për këtë vit dhe si një mundësi për tu takuar, për tu njohur dhe prezantuar. Në këtë tryezë jemi të gjithë në fakt, pjesa e përfaqësuesve të qeverisë shqiptare dhe sic janë dhe anëtarësia në Këshill Kombëtar të Shoqërisë Civile dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Ne kemi marrë një axhendë e cila ka qënë e përgatitur nga sekretariati si një mbledhje e parë kemi menduar të bëjmë këtë axhendë dhe ta ndajmë më ju, kështu që unë përveç se do të doja t'iu uroja një vit të mbarë të gjithëve dhe një vit të frytshëm dhe me suksese për të gjithë bashkë. Nuk dua që t'iu mbaj me fjalë të gjatë sepse ne së bashku kemi bërë disa takime të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile dhe doja shumë që të kalonim përmes axhendës. Por, dy fjalë do të doja që ti thoja, ne e vlerësojmë shumë partneritetin me shoqërinë civile, vlerësojmë shumë bashkëpunimin e frytshëm që kemi pasur ndër vite, me gjithë sfidat dhe problematikat që kemi, me gjithë hallet dhe shqetësimet që vetë shoqëria civile ka paraqitur në tryezat tona të diskutimeve por ashtu siç edhe çdo vit ne do të ecim përpara me

një kalendar punësh apo aktivitete, të cilat do të jenë ato që do të ndajmë mes nesh dhe do të jemi së bashku për t'i përcaktuar, dhe mendoj se në këto momente të proçeseve të Integritetit Europian partneriteti dhe bashkëpunimi është me të vërtetë i domosdoshëm, është vërtetë tepër transparent dhe është ajo çka duhet për të vijuar më pas me kontributin që shoqëria civile jep por edhe me atë çka qeveria shqiptare do të ofrojë në mbështetje të shoqërisë civile dhe gjithë problematikave që ndër vite janë hasur dhe që do të mund të zgjidhen në një moment në të cilin ne do t'i adresojmë nëpërmjet këtij Këshilli Kombëtar të Shoqërisë Civile. Kështu që unë do t'ia jap fjalën z. Vladimir Thano si nënkryetar që të vijojë më pas me rendin e ditës.

Z. Vladimir Thano: Faleminderit e dashur Denada, faleminderit të dashur përfaqësues të autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë, por edhe anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, përpara se të kalojmë me votimin e pjesës së parë që ka të bëjë pikërisht me Procesverbalin e fundit të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile për prezencë dhe për të parë nëse kuorumi është i mjaftueshëm për zhvillimin e mbledhjes do të dëshiroja, duke qenë se disa ministri kanë pësuar ndryshime dhe emërtesa të reja një prezantim shumë të shkurtër dhe ndërkohë që sekretariati mban shënim prezencën për kuorumin që është shumë e rëndësishme në bazë të rregullores për organizim dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile. Po e kaloj fjalën nga e majta ime.

Znj. Silva Caka: Faleminderit, duke ju uruar suksese, unë jam Silva Caka nga Ministria e Punëve të Brendshme. Faleminderit.

Z. Tedi Dobi: Mirëmëngjesi, është kënaqësi që të jemi në fillim të këtij viti në mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile. Unë jam Tedi Dobi zëvendësministër në Ministrinë e Drejtësisë.

Znj. Irida Laçi: Përshëndetje dhe faleminderit, për mua kjo është hera e parë, quhem Irida Laçi dhe jam drejtore e Drejtorisë së Komunikimit në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Znj. Elda Xhumari: Mirëmëngjesi të gjithëve, edhe për mua është hera e parë, jam Elda Xhumari zëvendësministre në Ministrinë e Mjedisit.

Z. Stavri Lako: Mirëmëngjes jam Stavri Lako përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

Z. Vilson Shehu: Mirëmëngjes, unë jam Vilson Shehu nga organizata The Youth of Ura.

Z. Vladimir Thano: Më falni, jeni anëtar i ri i Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile?

Z. Vilson Shehu: Po.

Znj. Esmeralda Demiraj: Përshëndetje të gjithëve, Esmeralda Demiraj nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve.

Znj. Arta Nikolli: Përshëndetje të gjithëve. Unë jam Arta Nikolli, vij nga organizata Consulting and Development Partners në Shkodër dhe për mua është hera e parë.

Z. Guri Lekloti: quhem Guri Lekloti Drejtor Kabineti në Ministrinë e Shtetit për Marrdhëniet me Parlamentin.

Znj. Elona Hoxha: Mirëmëngjes të gjithëve, unë jam Elona Hoxha zëvendësministre tjetër e Drejtësisë.

Z. Andi Kananj: Andi Kananaj drejtor ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Znj. Irena Kero: Irena Kero, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Znj. Andia Ndreka: përshëndetje të gjithëve, unë jam Andia Ndreka nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Znj. Mirela Koçi: Mirela Koçi nga Agjencia e Zhvillimit “ALUEDA”, anëtare e Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile.

Z. Indrit Seferi: Indrit Seferi anëtar i Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile.

Z. Nensi Dragoti: Nensi Dragoti përfaqësues i organizatës HASTE.

Znj. Irena Topalli: quhem Irena Topalli nga “Përtej Barrierave”, jam anëtare e re në Këshillin Kombëtar për Shoqërisë Civile.

Znj. Eglantina Bardhi: Eglantina Bardhi nga shoqata “Together for Life”, anëtare e vjetër e tani në dalje të Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile.

Z. Ergys Gezka: Mirëmëngjes të gjithëve, unë jam Ergys Gezka anëtar i Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile.

Znj. Berta Tuci: Mirëmëngjes të gjithëve, unë jam Blerta Tuci, drejtore ekzekutive e organizatës EU Policy Hub, anëtarja më e re e Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile.

Znj. Fabiola Ergo: Mirëdita të gjithëve, unë jam Fabiola Ergo, jam anëtare e vjetër tashmë edhe në moshë edhe në eksperiencë e Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile dhe po ruaj energjitë deri për në dalje nga ky Këshill Kombëtar për Shoqërisë Civile. Kam shumë kënaqësi që kam qënë pjesë e këtij forumi të Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile ku ne me zërin tonë mund të kontribuojmë ama mund të jemi dhe në një tavolinë siç jemi sot për të diskutuar të gjitha sfidat dhe problemet që të kemi mundësinë për ti zgjidhur së bashku me qeverinë qëndrore, me ju që jeni këtu që na dëgjoni dhe që kemi këtë mundësinë që jo vetëm të punojmë

me ministritë përkatëse ku ne kontribuojmë për fushën tonë por të jemi së bashku të gjithë, faleminderit.

Znj. Merita Xhafa: Mirëmëngjes dhe një vit të mbarë, unë jam Merita Xhafa Këshilltare e ministres së Ministrisë së Shëndetësisë dhe e Mirëqënies Sociale.

Z. Vladimir Thano: Faleminderit zonja Xhafa dhe besoj se e mbyllëm shumë mirë rrethin e ekosistemit, zonja Xhafa është një njohëse shumë e mirë e Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile kështuqë e falenderoj për rikthimin e saj. Mbledhja e fundit e Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile është mbajtur në datën 1 Prill 2025, për procedurë na duhet të bëjmë një votim për kalimin e procesverbalit të fundit për mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile, besoj jemi dakort për të aprovuar procesverbalin i cili është shpërndarë nga sekretariati. Ndërkohë do të shkojmë me formalizimin e axhendës së ditës. Axhenda e ditës është fjala e hapjes dhe aprovimi i rendit të ditës si më poshtë vijojmë, zonja Seferi nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mirëqënies Sociale, gjithashtu mban fjalën kryetari i Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile, me pas vijojmë më përditësimin e zgjedhjeve për anëtarët e rinj të Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, e cila luan rolin e sekretariatit Teknik për Këshillin Kombëtar për Shoqërisë Civile. Ngritja e një grupi punë mbi hartimin e një kalendari aktivitetesh dhe prioritetëve për Këshillin Kombëtar për Shoqërisë Civile me funksionalitete të plota, gjithashtu diskutime mbi procesin e zgjedhjeve për anëtarët e rinj të Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile të cilëve iu mbaron mandatet në shkurt të 2026 dhe miratimi i datës pasardhëse të mbledhjes së Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile, po ashtu dhe diskutime të tjera. Nuk e di zonja Seferi kishit diçka për të shtuar? Mirë meqënëse jemi në këtë fillim viti më duhet të bëj vetëm një ndërhyrje të shkurtër në lidhje më atë që çfarë është Këshilli Kombëtar për Shoqërisë Civile gjithashtu dhe për anëtarët e rinj të kabinetit të Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile. Kështu, në fund të vitit 2015, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin 119/2015 për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile, në 23 qershor 2016 në ambientet e kësaj ministrie, me saktë në Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë u mbajt takimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile. Më 4 Dhjetor 2017 anëtarët e shoqërisë civile në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar për Shoqërisë Civile zgjodhën zotin Blendi Dibra për zëvendës kryetar dhe tani dua që të futem pak në arsyetimin ligjor për të cilin është ngritur dhe funksionon Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile. Ligji paraqet se çdo institucion publik duhet të vejë në dispozicion të Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile informacionin e kërkuar për financimin e projekteve apo programeve të ojf-ve apo të oshc-ve si dhe çdo informacion që lidhet me mbështetjen e shoqërisë civile në vënd. Këshilli Kombëtar për Shoqërisë Civile raporton mbi veprimtarinë e tij të paktën një herë në vit pranë Këshillit të Ministrave ose sa herë që kërkohet nga ky i fundit. Ndaj mendoj se kemi përgjegjësinë dhe kjo është dhe për anëtarët e rinj që të dërgojnë në Këshillin e Ministrave atë çka ekosistemi që ne përfaqësojmë prodhon. E mishëruar në frymën e nxitjes së dialogut dhe asaj se çfarë parasheh Këshilli Kombëtar për Shoqërisë Civile detyra jonë është të këshillojmë, shpeshherë në takimet

që bëjmë me organizatat e shoqërisë civile është një këndvështrim ku ne jemi një këshill vendimmarrës, në fakt fjala këshilloj, të konsultoj është ajo të cilën ne duam ta përforcojmë tek anëtarët e shoqërisë civile. Këshilli Kombëtar për Shoqërisë Civile u krijua për të mundësuar dialogun dhe për të përfaqësuar interesat e organizatave të shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes dhe hartimin e politikave publike, në këtë kontekst më duhet të ritheksoj se rëndësia e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile qëndron në faktin se është organi i parë formal në Shqipëri, i krijuar posaçërisht për të ndërtuar një dialog të strukturuar ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve publike shqiptare. Raportet vlerësojnë këtë si kusht thelbësor të promovimit të një mjedisi bashkëpunues dhe transparent ku organizatat e shoqërisë civile mund të ndikojnë në politikat publike. Më falni për zgjatjen por janë gjashtë vite punë kështuqë do më duhet ta kaloj pak. Ndikimi dhe roli i Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile mbetet ende një platformë zyrtare përmes së cilës Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile ka mundësuar që organizatat e shoqërisë civile të komunikojnë drejtpërdrejtë me politikëbërësit. Kjo është një tryezë ku organizatat e shoqërisë civile kanë mundësinë të flasin me politikëbërësit, kështuqë gjej rastin të falenderoj çdo kryetar i cili ka qënë pjesë e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, i cili na ka formësuar edhe ne në dialogun kundrejt autoriteteve publike. Të nderuar kolegë Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile është forumi më i lartë i transparencës dhe llogaridhënies në nivel kombëtar dhe për rrjedhojë grupet e punës dhe dialogu i strukturuar që ne kemi ngritur në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile duhet të kthehet në një instrument të vlefshëm. Ajo çfarë ne kemi realizuar, më duhet ta ndaj me ju, është Takimi Kombëtar i Shoqërisë Civile i datës 24 Prill 2023. Ai përfaqëson një nga shembujt më domethënës të mënyrës sesi Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile e ushtron në praktikë rolin e tij ligjor dhe institucional. Në këtë takim i cili nuk ishte thjeshtë një aktivitet konsultues por një proces i mirëfilltë i pjesëmarrjes, ku organizatat e shoqërisë civile përmes punës në grupe tematike dhe përmes dialogut të hapur artikuluan prioritetet, shqetësimet dhe rekomandimet e tyre në mënyrë të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse. Rëndësia e këtij takimi ose e këtij workshop-i kombëtar qëndron në faktin se ai prodhoi një dokument dhe një sërë prioritetesh dhe rekomandimesh që lidhen drejtpërdrejt me mandatin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile që sekretariati do ta ndajë dhe me anëtarët e rinj të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Raportet për shoqërinë civile dhe raporti për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile i Komisionit European i dy apo tre viteve theksoi faktin që se Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile ka ende kapacitete të kufizuara për të artikulluar prioritetet e organizatave të shoqërisë civile. Pjesëmarrja jonë në procesin e Integritetit nuk duhet kërkuar natyrisht nga Brukseli por ajo duhet të garantohet nga vetë qeveria shqiptare përmes përfshirjes aktive tonën, pra të organizatave të shoqërisë civile. Fakti është që roli i shoqërisë civile po tkurret, prej vitit 2021 një numër i madh organizatash janë përballur me humbje drastike të burimeve sidomos pas humbjes së mbështetjes amerikane dhe ndërkombëtare, kjo ka lënë një boshllik jo vetëm financiar por edhe të kapaciteteve njerëzore me të cilat përballlet shoqëria civile. Shoqëria civile të nderuar kolegë në shumë zona të vendit sot mbijeton me vullnet, jo me mundësi. Kjo nuk mund të mbetet më një çështje që diskutohet vetëm mes nesh. Anëtarët

e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile janë vullnetarë dhe ky është një shembull shumë i mirë i altruizmit, zoti Vilson vjen nga Dimali dhe e përgëzoj për pjesëmarrjen e tij dhe gjithashtu dhe kolegë të tjerë, ky është një shembull i altruizmit brenda shoqërisë civile që nuk duhet humbasë. Ne nuk duhet të jemi thjeshtë vëzhgues të ngjarjeve siç ka ndodhur me Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile por edhe se jemi në një anije dhe era na çon në një drejtim ne kemi mundësinë që velat t'i drejtojmë dhe orientojmë drejt një kanali të sigurt. Jam në dilemë që shpesh e kam pasur gjatë gjithë këtij rrugëtimi në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile, të them të drejtën kur kam ardhur në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile kam qënë anëtar, më tej nënkryetar, në atë kohë kam qënë i martuar, pastaj u bëra me fëmijën e parë, më pas me fëmijën e dytë por kjo tregon dhe njëherë se sfidat që kalon shoqëria, sfidat që kalon shoqëria civile dhe sfidat që kalojmë ne janë krejtësisht sfida të shoqërisë dhe shoqëria civile duhet parë natyrshëm dhe me problematikat që ka dhe vetë shoqëria. Një nga pyetjet që unë dua që t'i kthehem dhe kjo është për referencë dhe kritikizëm drejt ekosistemit a duhet t'i rikthehet shoqëria civile vetë shoqërisë. Shpesh herë diskutohet sikur shoqëria civile është bërë shumë distante kundrejt shoqërisë, shpeshherë diskutohet gjuha e shoqërisë civile është më e ndërlikuar dhe qytetarët besoj se duan një gjuhë më të thjeshtë. A po flasim më shumë më njëri-tjetrin dhe më pak me qytetarët, aburon shoqëria civile nga nevojat reale të shoqërisë apo nga axhendat dhe portofolet e donatorëve? Kjo është një gjë që Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile mund ta adresojë ndryshe nga donatorët në vend. Problematikat e ndodhura në ditët e fundit që lidhen me përmytjen dhe me katastrofat natyrore e kanë bërë shoqërinë civile sërish një nga aktorët të rëndësishëm, Fabiola vjen nga zona të cilat janë të përmytura por gjithashtu për të treguar shembuj që shoqëria civile jep në atë që quhet ekosistemi social kontributin e tij thelbësor në systemin shëndetësor, në systemin e zhvillimit ekonomik siç është dhe rasti i Mirelës nga Vlora, këto janë të gjitha shembuj që tregojnë sesa e rëndësishme është dhe se si duhet të përforcohen mekanizmat e shoqërisë civile në këtë Këshill Kombëtar për Shoqërinë Civile. Por a ka ende probleme? Po, sfidat e mëdha që krijojnë vullnet politik dhe publik dhe unë besoj që edhe zonja kryetare në takimin e parë informal që kam pasur me të ka shprehur gadishmërinë për të qënë pjesë vitale e këtij Këshilli. Po, regjistrimi elektronik i ofr-ve dhe lidhja e e tij me sistemin e ri që po përgatitet nga drejtoria e tatim taksave është premtuar dhe nuk është zhvilluar më tej. Zbatueshmëria e ligjit që përjashton oshc-të nga detyrimi i tvsh-së, i shumë diskutuar i ngritur nga zonja Koçi por edhe nga të gjithë kolegët, Udhërrëfyesi për një Mjedis Mundësues, përditësimin e tij ne nuk e kemi ende, mundësia që Këshilli të ketë një tablo më të qartë buron nga ligji funksional i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Korniza legjislative për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile e parashikuar në Udhërrëfyesin për funksionimin institucioneve demokratike është ende një proces i pa përfunduar dhe duhet të nisë sipas mendimit tonë në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile pa vonesë për të përmirësuar funksionimin e tij dhe për të siguruar përfshirjen më të madhe të institucioneve publike dhe shoqërisë civile. Ekziston nevoja që krahas vlerësimit dhe konstatimit të sfidave të cilat janë identifikuar dhe trajtuar gjërësisht në një sërë raportesh të organizatave të rëndësishme shqiptare dhe ndërkombëtare të ravalizohet me

proçesin e nevojshëm për realizimin e një reforme efektive për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile, pasi ligji që ne kemi aktualisht në dispozicion është një ligj i cili pamundëson disa nga çështjet kyçe me të cilat Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile dëshiron të adresojë. Kjo ishte fjala ime përse i përket sfidave me të cilat përballlet Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile, gjithashtu Udhërrëfyesi për institucionet demokratike, një Udhërrëfyes i nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë i cili në një nivel agregati dëshiron që të përpunojë le të themi një ligj të ri më funksional të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile por edhe sfidën për ta sjellë më afër është një domosdoshmëri dhe unë uroj dhe besoj duke mirëkuptuar sepse ne kemi qënë shpeshherë në shumë mbledhje dhe më lejoni që t'i falenderoj autoritetet publike sepse kemi krijuar një aleancë dhe një friendship shumë të mirë me ta, të kemi tashmë nevojën që autoritetet publike të kenë një vullnet politik më të madh kundrejt Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe ky mekanizëm të jetë një shembull edhe për ata të cilët na kanë gjykuar se përgjithësisht ne gjykohe mi më shumë nga ekosistemi jonë sesa nga ana tjetër na kanë gjykuar si një Këshill i cili duhet ta forcojë rolin e që ka dhe t'i përfaqësojë organizatat e shoqërisë civile. Unë këtu po e përfundoj fjalën timë, nuk e di nëse zonja Seferi kishte diçka për të shtuar ose do të vazhdojmë me axhendën.

Znj. Denada Seferi: Vazhdojmë me axhendën.

Z. Vladimir Thano: Vazhdojmë me axhendën. Mirë kemi përditësimin mbi zgjedhjet e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe prezantimin me anëtarët e rinj të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Znj. Andia Ndreka: Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në cilësinë e sekretariatit të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, në muajin Maj-Qershor hapi thirrjen për dërgimin e kandidaturave për përzgjedhjen e 5 anëtarëve të rinj të KKSHC-së, përfaqësues nga shoqëria civile. Afati fillestar për propozimin e kandidaturave dhe dorëzimin e dokumentacionit u parashikua data 27 Qershor 2025. Pas mbledhjes së datës 3 korrik 2025, komisioni i vlerësimeve të aplikimeve në kuadër të plotësimit të vendeve vakante vendosi që afati për mbledhjen e kandidaturave të shtyhet për shkak të mos kandidimit të mjaftueshëm nga ana e shoqërisë civile. Data e kandidimit për anëtarë të KKShC-së u vendos 26 Shtator 2025 deri me datë 10 Tetor 2025. Mbas dorëzimit të dokumentacionit, u bë edhe vlerësimi i kandidaturave nga komisioni i ngjitur pranë AMSHC-së. Pas kësaj, në datën 28 Tetor 2025 deri me datë 04 Nëntor 2025 nisi proçesi i votimit për 11 kandidaturat për anëtar të KKShC-së.

Kandidaturat u hapën për dy fusha veprimi:

1. Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE - (3 anëtarë)
2. Zhvillimi ekonomik, territorial dhe mjedisor – (2 anëtarë)

Në total aplikuan për vendet vakante në Këshill 13 persona, ku 11 prej tyre u kualifikuan për procesin e votimit. Pjesa më e madhe e aplikimeve kandiduan për herë të parë, dhe u përzgjedhën fitues anëtarët e mëposhtëm:

Në prioriteti nr.1: Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE u shpallën fitues:

1. Znj. Miriam Reçi
2. Znj. Blerta Tuci
3. Znj. Irena Topalli

Në prioriteti nr. 2: Zhvillimi ekonomik, territorial dhe mjedisor u shpallën fitues:

1. Znj. Arta Nikolli
2. Z. Vilson Shehu

Anëtarët që iu mbaroi mandati janë përkatësisht:

Prioriteti nr.1: Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE:

1. Z. Altin Hazizaj
2. Znj. Mirela Juka
3. Z. Nikolla Gjurgjaj

Prioriteti nr. 2: Zhvillimi ekonomik, territorial dhe mjedisor

1. Z. Vladimir Thano
2. Z. Xhimi Vila

Kaq kisha për të ndarë me ju për pikën në axhendë, Përditësimin mbi zgjedhjet e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe prezantimin me anëtarët e rinj të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Z. Vladimir Thano: Faleminderit e dashur Andia, mirë në këto moment do vijojmë, në fakt e gjithë axhenda e ditës së sotme është për të kuptuar nga mbledhja e fundit e datës 1 Prill 2025, ishte një takim i cili krijoji një proces të autoriteteve publike mbi financat por gjithashtu mbi mbështetjen e shoqërisë civile. Ishte një mbledhje e tejzgjatur dhe ne menduam që kjo mbledhje e parë e vitit do ishte një mbledhje prezantuese me kryetaren e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, që besoj dhe uroj që do ta bëjmë së shpejti dhe gjithashtu ishte një mbledhje konstituive e cila në materien e saj dëshiron të përmbajë këtë mesazh. Mirë, vijojmë me ngritjen e një grupi pune mbi hartimin e kalendarit të aktiviteteve dhe prioritetëve për

Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile, në këtë moment është shumë e rëndësishme për të pasur një kalendar aktiviteteve por gjithashtu për të pasur edhe prioritete të cilat ne i kemi parashikuar përgjatë vitit të kaluar. Siç e thashë edhe një herë, grupi i punës do të ketë mundësinë të punojë mbi disa dokumenta të krijuar, ajo që quhet Co Creation plani i bashkëkrijimit, në mënyrë që të kemi një plan pune dhe një kalendar aktiviteteve, i cili do të aprovohet në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Unë e lë të hapur diskutimin, kush dëshiron të bëhet pjesë e grupit të punës për kalendarin e aktiviteteve dhe prioritetetve të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile? Nga shoqëria civile? Zoti Gezka.

Z. Ergys Gezka: vetëm diçka do të doja të pyesja sekretariatën, si p.sh unë apo Eglantina apo të tjerë që ju përfundojnë mandatet sepse e kemi humbur këtë llogaritjen e mandateve kur i bie që të mbarojnë?

Znj. Andia Ndreka: Në shkurt të vitit 2026, u mbarojnë mandatet dhe 8 anëtarëve të tjerë të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, por kjo është një pikë që do ta diskutojmë më pas në mbledhje.

Z. Ergys Gezka: Ok, shumë faleminderit. Është e rëndësishme për të kuptuar këtë çështjen e krijimit të grupit, duke ditur që në shkurt të 2026 u mbarojnë mandatet një pjese të madhe të anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Z. Vladimir Thano: Fabiola?

Znj. Fabiola Egro: Në fakt edhe unë doja të vazhdoja atë që filloi Ergysi, që tashmë jemi në një moment, që 8 anëtarët tjerë të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile largohen në fund të shkurtit, do jemi në një proces që dhe më parë e kemi njohur, sepse jemi të ftuar të njohim anëtarët e rinj, po anashkaloj axhendën në fakt, por doli nga përbërja e grupit të punës për kalendarin. Sigurisht, që ne jemi të interesuar përderisa e kemi ngritur dhe në mbledhjen e kaluar që duhet një kalendar aktiviteteve dhe prioritetesh, por duhet ta ndjekim këtë kalendar, dhe jo vetëm grupi i punës në bazë prioritetesh, apo fushave apo çdo gjëje tjetër që do të zgjedhin për të vazhduar punën dhe ta kemi përpara dhe pse jo për të kërkuar edhe mundësi buxhetimi që ky vullnetarizëm që jemi këtu për shkak se kolegët tanë na kanë besuar dhe na kanë sjellë këtu të jemi të zgjedhur, të jetë një përfaqësim sa më i mirë jo vetëm me vullnetarizëm por të jenë dhe aktivitetet apo programet që ne duam të zhvillojmë të jenë të buxhetuara, qoftë kjo nga buxheti i shtetit që mund të kërkojmë apo dhe nga të tjerë që mund të jenë të interesuar që ky Këshill Kombëtar për Shoqërinë Civile, që kjo platformë apo ky organ që është organi i parë në Shqipëri, të themi i njohur dhe vazhdon të jetë, se përderisa vazhdon të jetë dhe ka mbijetuar të jetë i fuqishëm dhe i fortë që të kryejë detyrën e vet. Kemi luhate shumë të mëdha, siç Vladimiri e tha, kemi një periudhë ku Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile ka qënë në heshtje, nuk mund të them në fjetje sepse janë bërë takimet ka vazhduar normalisht por nuk ka pasur një forcë apo një zë të fuqishëm. Tani me Integrimin në Bashkimin Europian duhet të jetë vërtetë organ i cili është aktiv, të gjithë ne duhet të jemi më

aktiv që të luftojmë dhe të punojmë sëbashku për përmbushjen e të gjitha detyrave apo t'i sjellim këto në tavolinë dhe t'i diskutojmë. Prandaj, edhe interesi, pavarësisht se ka një largim apo pakësim të donatorëve, interesi i tyre është i matur nëqoftëse ne kemi vërtetë një program, kemi strategji me aktivitete. Tani, në këtë moment ku ne e kemi çuar përpara ka qënë vërtetë një forcë e madhe, janë organizuar, janë ngritur edhe takime apo dhe me donatorë të ndryshëm, ne kishim dhe një takim me OSBE-në që na u ofrua sepse ka bërë një vlerësim për gjithë aktivitetin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe një krahasim me rajonin, me Kroacinë, Serbinë, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut këto mbaj mend që ishin në mos gaboj dhe ka nxjerrë rekomandime. Kështuqë këto rekomandime, ne së bashku i diskutuam në grupe pune. Këto rekomandime ne duhet t'i vëmë në jetë në kalendarin e aktiviteteve. Tani, problemi është se nëse ikim të gjithë, i bie që në mars ky Këshill Kombëtar për Shoqërinë Civile zëvendësohet 100%. Domethënë eksperiencia e anëtarëve të mëparshëm nuk delegohet, sepse kjo është pjesë e vullnetarizmit, unë e thashë se secili nga ne ka detyrat e veta shumë të mëdha sipas fushës dhe punon për organizatat apo për shoqërisë civile. Një sugjerim që do kisha unë do ishte, sugjerim që unë mëndoja ta hedhim në votë dhe ta diskutojmë këtu do të ishte e para që nënkryetari i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile të vazhdojë, sepse ai mund të jetë edhe historia e mund të vazhdojë edhe me anëtarët e rinj. Sigurisht ne jemi të gatshëm besoj, se po flas në emër të anëtarëve të vjetër që të vazhdojmë për një muaj apo dy muaj apo për sa kohë edhe kuadri legjislativ i organizatave të shoqërisë civile por edhe i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile është i vjetër është i pa përditësuar dhe duhet ndryshuar, e tani është momenti i duhur që të shihen edhe këto ndryshime.

Znj. Denada Seferi: Meqënëse jemi në këtë moment, unë do të doja t'iu përditësoja mbi disa gjëra të cilat kanë lidhje dhe me atë e me atë çka Fabiola përmendi. Në rradhë të parë ne si anëtarë apo drejtues të këtij Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile, kemi kërkuar mbështetjen e disa organizmave ndërkombëtar që pas analizës që u bë për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile në lidhje me ligjin dhe me Udhërrëfyesin e Institucioneve Demokratike kemi kërkuar eksperiencën ndërkombëtare dhe konsulencën ndërkombëtare që nga OSBE dhe nga EUD, pra nga Delegacioni European, të cilët janë duke përzgjedhur ekspertët e tyre ndërkombëtar për të hartuar ligjin dhe Udhërrëfyesin. Dhe jemi në momentin e duhur, në të cilin ne mund të adresojmë më së miri të gjithë nevojat që kemi për të ndryshuar ligjin dhe ato problematika dhe sfida që deri sot i kemi pasur në lidhje me Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile. Kështuqë ky grup i punës, i cili do të bëhet pjesë për hartimin e kalendarit të aktiviteteve dhe prioritetetve, propozoj që të jetë dhe grupi i punës, i cili së bashku me ministrinë tonë dhe me ekspertizën ndërkombëtare të çojë përpara edhe ligjin edhe Udhërrëfyesin. Sepse, më mirë se ju që jeni pjesë e shoqërisë civile, të cilët përfshirë dhe të gjithë anëtarët e qeverisë që ne jemi këtu prezent për fushat përkatëse, më së miri mund të çojmë përpara, në bazë të analizës së kryer duke pasur si një udhërrëfyes dhe eksperiencën ndërkombëtare dhe ekspertët ndërkombëtar të vijnë më pas edhe me hartimin e Ligjit dhe të Udhërrëfyesit. Nuk janë proçese të vështira, të paktën për hartimin e tyre do të na duhet pak efijencë ndoshta në momentin që caktohen dhe ekspertët ndërkombëtar do t'iu duhet të

mbledhjen ndoshta dhe pak më shpesh në mënyrë që ne të ecim përpara me hartimin dhe me draftet dhe më pas të konsultohen sipas të gjithë proceseve konsultative të cilat janë të shkruara në ligjin përsa i përket Konsultimit Publik. Kjo ishte e para, të dyja dokumentat do të duhet të rishikohen, sepse janë në fazën e tyre të rishikimit. Pjesa e dytë, unë do të propozoj, përsa i përket nënkryetarit, deri në momenti që do të përzgjidhen anëtarët e rinj, i bashkohem asaj që parafolësit thanë ne të mbajmë nënkryetarin dhe ta kemi këtu pjesë të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Sigurisht, ky vjen si një propozim i diskutuar me ministren, i diskutuar mes nesh dhe e hedh këtu për ta dakortësuar në mënyrë që ne të kemi një funksionim normal të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Faleminderit.

Z. Andi Kananaj: Sa për saktësim, mendoj që nëse ngrejmë një grup pune, grupi i punës nuk ka mandate dhe detyrimisht i bie që mund të kthehen të jenë dhe pa mandat antëtarë në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile, sepse mendoj që duhet të jenë ekspertë dhe njerëz që e njohin këtë proces, kështu që mund të ngarkohen edhe për këtë proces pune anëtarët e vjetër pa pasur nevojë që të presim një grup tjetër i cili do të vijë, apo për aq sa do të zgjasin zgjedhjet e anëtarëve të rinj të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Pra, mendoj se grupi i punës për të krijuar një proces i cili do të ndihmojë edhe në skuadrën tjetër për hartimin e ligjit dhe të Udhërrëfyesit do të ndihmojë edhe anëtarët e rinj që do të vijnë.

Z. Vladimir Thano: Shumë faleminderit, po Ergys?

Z. Ergys Gezka: Unë do të dëshiroja që të sillja në vëmendje një gjë shumë bazike, e cila është zgjedhja e parë e detyrueshme që ka të bëjë me ligjin aktual të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Nuk është një opinion që ka të bëjë me dakortësinë tonë, me vullnetin e ministrisë apo të sekretariatit por mbi të gjitha me respektimin e ligjit në fuqi. Ajo që unë do të doja është që pas këtyre dy mandateve të mijat por edhe të shumë kolegëve këtu, të ishte e zezë mbi të bardhë e shkruar dhe e publikuar një raport mbi çfarë ka bërë Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe cila ka qënë përgjigjia institucionale dhe zyrtare e institucioneve të cilat kanë patur të bëjnë me kërkesat tona. I referohem specifikisht dy tematikave të cilat vazhdimisht nëpër, mbledhje të ndryshme na janë servirur si të bëshme, se puna po bëhet po vijon, se është një punë teknike për të cilën po ecet përpara duke ju referuar pikësëpari regjistrimit elektronik të ojf-ve, për tu zhvendosur sëfundmi nga gjykata. Që të kemi një regjistër elektronik dhe të bëhen të mundur ndryshimet në mënyrë më të lehtë për funksionimin e organizatave të shoqërisë civile. Vazhdimisht nëpër mbledhje të ndryshme na është bërë e ditur që po bëhet edhe pak, edhe dy muaj edhe tre muaj, kemi pasur disa ndryshime disa teknikalitete.

Znj. Denada Seferi: Nga ministrinë përkatëse?

Z. Ergys Gezka: Nga ministrinë përkatëse, kjo nuk e bën më pak të rëndësishme. Ideja është në fund të ditës puna e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Dhe pjesa e dytë për të cilën është folur më tepër akoma është por që sigurisht paraqet vështirësinë më të madhe por për

këndvështrimin tim të pajustificueshme gjithsesi ka të bëjë çështjen e përjashtimit të tvsh-së. Për këtë as nuk është folur, kemi pasur mundësinë të asistojmë në një debat midis SASPAC-ut dhe Ministrisë së Financave në këtë tryezë, ku shihet qartë që nuk ka asnjë dialog në nivel teknik edhe midis specialistëve edhe departamenteve të Agjencisë dhe Ministrisë së Financave. Do të ishte shumë e drejtë që të mos mbetej thjeshtë një opinion, mungesa e punës konkrete dhe e rezultateve të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Të publikohej dhe të paraqitej gjithashtu edhe tek Delegacioni European në Tiranë, i cili për hir të së vërtetës edhe në këtë moment në linjë me punën aq sa ka qënë e këtij Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile ecën paralel pasi në këtë moment jam në dijeni që po përzgjedhin ekspertët e rinj të cilët do të ripunojnë një material që ka të bëjë me këtë manualin e mjedisit mundësues për shoqërinë civile, në këndvështrimin tim mbetet një “tick the box” në nivel delegacioni, në nivel qeverie dhe në nivel raportesh përse i përket procesit të Integritetit të Shqipërisë në BE, por në nivel konkret shoqëria civile dhe përfituesit final, pra qytetarët nuk mendoj se kanë patur ndonjë dobi nga ekzistenca e këtyre organizmave që për hir të së vërtetës marrin kohë, marrin mund dhe duhet që të jemi shumë të singertë me qytetarët dhe me të gjithë anëtarët e organizatave tona e po ashtu me shoqërinë shqiptare se çfarë është bërë, çfarë është tentuar të bëhet dhe çfarë nuk është bërë? Sot e kësaj dite ne jemi, dhe tani po e ul pak nivelin e bisedës në nivel barcalete në nivel të shoqërisë civile. A jeni akoma ju? Pse nuk ju ka mbaruar Akoma mandati etj etj? Kjo sepse nuk po shikojnë asnjë lloj pune, po të pyes Fabiolën do të thotë unë kam harxhuar absolutisht shumë kohë për tematikat që kam trajtuar me anëtarë të ndryshëm që janë përfshirë kush më shumë kush më pak në këtë proces për hir të imenjimeve të tyre por dhe për hir të vullnetit që ata kanë pasur gjatë mandatit të tyre, por sot e kësaj dite unë them që anëtarët e rinj, kjo është trashëgimia ime në dalje nga Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile, duhet të masin në mënyrë të vazhdueshme se çfarë është bërë dhe se çfarë nuk është bërë. Kjo gjë duhet të bëhet publike me qëllim që të dihet gjërësisht se çfarë punohet dhe çfarë mbetet në tentativë. Mund të them deri diku një lloj fasade përse i përket temave që trajtohen, përse më takon ne nuk kemi arritur as regjistrimin e një adrese të re të një ofj-je e cila sot e kësaj dite shkakton probleme pafund në nivel bankar dhe në çdo lloj niveli tjetër në zbatim të projekteve. Nuk po flasim për ndryshim personash, bordesh, drejtorësh ekzekutiv, por po flasim për ndryshim adrese ofj-je. Kjo gjë kërkon sot e kësaj dite në rastin më të mirë dy muaj e gjysëm në rastin më të keq edhe dhjetë muaj nga gjykata e rrethit Tiranë, sigurisht nuk jemi ne që të diktojmë punën e tyre, po ne mund të kishim bërë shumë më tepër, po ashtu dhe vullneti institucional në këtë tryezë mund të kishte bërë shumë më tepër për krijimin e kësaj databaze elektronike që do të bënte të mundur funksionimin më të mirë të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri. Kjo ishte ajo çka kisha për të thënë, pas mendoj që çdo gjë tjetër do të ishte e përsëritur. Suksese anëtarëve të rinj, uroj që realisht të mund të merrni aq sa mundeni dhe aq sa ne do t’iu japim për të vijuar një lloj pune pak më dinamike dhe pak më të prerë përse i përket tematikave që trajtohen në këto instanca. Faleminderit!

Znj. Denada Seferi: Më falni, a mundem të përgjigjem? Çdo gjë çfarë është diskutuar në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile si një bord këshillimor të cilin na e bëri

me dije dhe e dimë shumë mirë të gjithë që jemi pjesë e këtij bordi këshillimor, edhe Ladi, nëpërmjet aktivitetit që kemi. Ajo çka ne jemi munduar dhe kemi adresuar në të gjitha mbledhjet e tij, është që të kishim institucionet e duhura të cilat janë pjesë të tryezave dhe të diskutimeve që bëhen, por jo vetëm kaq, ajo që ne kërkojmë që të jemi dhe të drejtojmë dhe të adresojmë të gjitha problematikat është të shkojnë pikërisht në veshin e duhur duke thënë që shoqëria civile ka pasur një, dy, tre problematika, të gjitha janë të adresuara nëpërmjet këtij Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile ashtu siç ne të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që qoftë tek SASPAC, qoftë tek Ministria e Financave, qoftë tek Ministria e Drejtësisë, qoftë tek organet e Këshillit të Lartë Gjyqsor përse i përket regjistrimit elektronik gjithçka është dërguar edhe me shkrim, ndërkohë janë ftuar dhe në tryezat tona dhe kanë qënë pjesë e tyre. Sigurisht që proceset janë të gjata dhe kërkojnë kohën e tyre ,normalisht pjesa e tvsh duhet të ishte adresuar por është pjesë e një politike të Ministrisë së Financave të cilën ne e kemi adresuar në disa mbledhje të këtij Këshilli sigurisht që detyrimi ynë është të këshillojmë institucionet dhe ti dërgojmë dhe adresojmë atyre ato problematika të cilat janë, disa prej tyre duhet të ishin edhe të zgjidhura por politikat e tyre janë pikërisht të përcaktuara në procedura, ndoshta në proceset e integritetit europian duhet të jemi pak më të shpejtuar për të ecuar ndoshta me të gjitha ato çështjet që janë ngritur disa herë në KKSHC. Do doja t'ia jepja fjalën edhe Tedit i cili më kërkoi fjalën.

Z. Tedi Dobi: Në fakt besoj është e rëndësishme si tematikë meqë është diskutuar disa herë. Çështja e regjistrimit është një problematike shumë vjecare e cila vjen në dy kontekste , në kontekstin kushtetues dhe teknik, kushtetues e thotë vete kushtetuta që organizatat e shoqërisë civile duhet të regjistrohen në gjykatë, dhe interpretimi i gjykatës kushtetuese që tashmë ne kemi bërë dhe ndryshimet përkatëse ligjin për regjistrimin e ofj është parashikuar që cdo gjë kalon dhe ato që ne i kishim kaluar kancelarit për të lehtësuar procesin të kalojë sërish tek gjyqtari për shkak të interpretimit të dhënë, por ajo që është lajmi pozitiv ka të bëjë me pjesën teknike, tashmë Këshilli i Lartë Gjyqësor ka filluar me implementimin e sistemit të ri të menaxhimit i cili ka filluar në fillim të muajit shtator dhe ku presim maksimalisht brenda fundit të vitit 2026 ose fillim të vitit 2027 të kemi sistemin ku janë parashikuar dhe modulet përkatëse për pjesën e regjistrimit , të regjistrimit final, për mbajtjen e të dhënave dhe kjo do të na ndihmojë në avancimin më tej. Kemi bashkëpunuar me KLGJ që është një organ kushtetues i pavarur, por në bashkëpunim ne kemi dhe një strategji kombëtare për prevalimin e çështjeve dhe urrëdhëfyes për efikasitet të sistemit gjyqësor me anë të së cilës janë vendosur një sërë fushash prioritare ku është dhe pjesa e regjistrimit të OJF ku po merren masat e caktuara. Një nga masat që po diskutohet është rritja e numrit të këshilltareve gjyqësor dhe në gjykatën e shkallës së parë, që një pjesë e proceseve të natyrës teknike që sot është i detyruar gjyqtari t'i bëjë vet dhe normalisht i merr kohë të kalojë tek pjesa e këshilltarit, ku po diskutojmë për të shtuar rreth 20 këshilltarë të rinj gjyqësor ku pak a shumë 10 shkojnë për gjykatën e Tiranës, nga këto roli kryesor do të jetë regjistrimi dhe ekzekutimi i titujve ekzekutiv, dy elemente që kanë vlerë për të gjithë shoqërinë, por edhe për organizatat e shoqërisë civile kanë një vlerë të posaçme.

Për sa vjen çështja tek fusha e dytë, normalisht tani po bëhet gati dy vjet te KKSHC ku është diskutuar dhe me Saspak-un dhe di që punë është bërë por patjetër që janë proçese të komplikuar që urojmë që do marrin zgjidhjen sa më shpejt është e mundur. Faleminderit.

Znj.Eglantina Bardhi: Ky Këshill është i destinuar për të gjetur justifikime për gjithçka që është propozuar dhe vërtet që ne skemi patur në dorë sepse fakti që është një Këshill që ska vendimarrje saktësisht ndonjëherë kalon dhe në qesharake ajo pjesa që mendon që po këshillon sna begenis njeri dhe në tre vite që jam të paktën po të më pyesesh sot çfarë u zgjidh një gjë çfarëdo lloj nuk di t'ua them dhe kolegëve të mi të cilët më kanë votuar dhe jam këtu. Mund ta quaj dhe si një ndër nga dështimet e mia më të mëdha në karrierë, në çdo gjë jam përpjekur të jap kontributin tim por realisht shpresoj që ekspertët e rinj apo të këtë një riformatim të ketij këshilli që të mos jetë vetëm një fasadë. Një fasadë që hajt se po vijmë se jemi për të ardhur, për të folur e të dëgjuar njëri tjetrin e për ta parë në sy dhe të bëjmë disa foto dhe u bë kjo sepse kshu na i kërkojnë instancat dhe kështu na pëlqen dhe delegacioni e cila e ka krijuar, kjo është ndonjëherë të gënjejme dhe veten tonë, por e kapim veten tonë duke gënjyer por po e bërë shpesh kalon në disa haluçinacione që si vlen askujt. Unë kam mundesi të rikandidoj në bazë të ligjit ma lejon këtë, dhe nuk do ta bëj, sepse ishte një eksperiencë mjaftueshëm për të parë që mënyra e funksionimit apo pafuqia për të bërë diçka, unë jam shumë e fuqishme në atë organizatën timë ku mund të përdor të drejtën për ligjin për informim, mund të përdor shumë mekanizma të tjera apo gjykatën sic e kam përdorur dhe arrin një rezultat, këtu nuk arrita asgjë, pra ne nuk arritëm asgjë. Vijmë këtu në mënyrë vullnetare, shpenzojmë kohën tonë, mendjen tonë patjetër se përpiqemi të përgatitemi dhe të dëgjojmë dhe hallet e atyre që i përfaqësojmë. Unë sinqerisht ju uroj suksese, në të djathtën time është një kolege shumë e nderuar që punon me rininë dhe është anëtare e re dhe Artën e njoh është një kolege që ka dhënë shumë në shoqërinë civile, e di që do bëni maksimumin tuaj dhe kam më shumë shpresa në fakt tek shoqëria civile se përfaqësuesit e institucionet që janë të deleguar për të ardhur, ose i thonë shkoni se duhet mbushur ai vendi karriges, jam e sigurt që kështu funksionon në shumicën e kohës, por ne jemi me dëshirë këtu. Kemi kandiduar, na kanë zgjedhur dhe kemi ardhur me një dëshirë shumë të madhe, dhe uroj vërtet që të marrë një rol ky Këshill dhe të mos jetë më një fasadë, thjesht për tu bërë. Unë sot nëse dikush më pyet çfarë u arrit, nuk di të citoj një arritje që u vazhdua nga fillimi dhe vajti deri në fund, është në proçes unë kam tre vite që e dëgjoj këtë dhe nuk dua të shpenzoj dhe tre vite të tjera të jetës time eshte në proçes, janë shumë vite janë vitet tona. Faleminderit dhe nënkryetarit, shpresoj ta vazhdojë se ka qënë shumë aktiv, do doja shumë të ishte dhe kryetarja e re ne seancë, shpeshherë nuk e kemi patur dhe në fakt nuk është një pozitë që delegohet që dërgon zakonisht Znj.Seferi, kështuqë dhe kjo është një lloj fasade pra nuk delegohet, shko pak ti se unë kam ca punë apo ndodhi një emergjencë që ka ndodhur shpesh, ne nuk e kemi patur kryetarin, në tre vite unë dy herë e kam takuar kryetarin, në dy seanca dhe kjo është një gjë sa për tu thënë. Unë skam patur asgjë në dorë por vetëm se di të bëj oponencën atë që përpiqem ta bëj jo vetëm këtu por kudo që jam, dhe kolegët e rinj vetëm fjalën kemi në dorë të paktën thuajeni. Falemiderit. Pres replika patjetër.

Z. Deanada Seferi: Mendoj që ju keni bërë dhe keni dhënë kontributin tuaj vullnetar, dështimi nuk është pjesë e asnjë tryeze, përkundrazi ku bashkëpunohet dhe ka partneritet ai tregon një vullnet të mirë të të dy palëve për të diskutuar dhe çuar para proçese. Ajo c'ka ju thoni këtu kemi të gjithë zëvendësministrat më të nderuar anëtarë të qeverisë të cilat janë të mandatuar nga ministrat e tyre për të marrë pjesë jo vetëm në tryeza dhe padiskutim me asnjë lloj fasade. Kjo është puna që ne bëjmë cdo ditë, Ky është portofoli ynë dhe ajo çka ne duam të çojmë përpara. Siç ju keni dhënë dhe jepni kontributin tuaj vullnetar ne japim 24/24 orë dhe qëndrojmë pa parë familjet tona pikërisht për tu bërë pjesë e këtyre tryezave dhe për të çuar përpara gjithcka ju mendoni që është e rëndësishme. Në portofolin tim ministrja ka vënë çështje të cilat janë të lidhura më të gjitha çështjet sociale, pikërisht për këtë arsye unë sot jam këtu ashtu si edhe në të gjitha mbledhjet e tjera, ashtu si të gjithë zëvendësministrat e tjerë jam pjesë e kësaj tryeze, kjo është për të treguar sa të gatshëm jemi ne dhe se si ne respektojmë partneritetet dhe këshillat kombëtarë të shoqërisë civile, që unë mendoj që në tre vjet ky Këshill Kombëtar i Shoqërisë Civile ka bërë në mënyrë të respektuar dhe me dinjitet punën e tij për të adresuar të gjitha problematikat dhe sfidat, kështu që unë mendoj që këtu është bërë një punë shumë e mirë nga të gjithë ju anëtarët, ku vërtet keni dhënë kontributin tuaj të çmuar. Shumë faleminderit për kontributin tuaj, shumë faleminderit për partneritetin tuaj.

Z. Vladimir Thano: Për proçedurë, në lidhje me rolin që kanë anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, Znj. Seferi është anëtare e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile dhe përfaqëson minsitrinë e linjës. E dyta ka të bëjë me aspektin e rregullimit, po, detyra nuk delegohet, por ligji parashikon që në rastet kur nuk ndodhet kryetari është nënkryetari. Ka një problem shoqëria civile që do të takojë kryetarin , edhe kjo është një sfidë e imja që kam pasur me të gjithë anëtarët dhe mund të jetë dhe një pjesë e sukseshme por dhe një pjesë e dështimit të asaj që konsiderohet bashkë ekzistencë, kështuqë do doja të tërhiqja vëmendjen dhe të të riktheja në vëmendje ke qënë një nga personat e më të votuar nga shoqëria civile, vazhdon mban një mandat të rëndësishëm si aktor i shoqërisë civile, kam parë për së largu projektin e fundit që ka qendra juaj dhe që lidhet me zhvillim e shoqërisë civile, pres me padurim që rezultatet e projektit që Qendra “Together for Life” ka në lidhje me rritjen e kapacitetve të shoqërisë civile të jenë në tryezën e KKSHC. Shpesh herë puna më e mirë është ajo që të paguajnë por unë kam zgjedhur këtë punën me me pak para por edhe me dinjitet., kështuqë ky është dhe një Këshill që njerëzit që vijnë natyrisht unë kam pas kontradikta shpeshherë edhe me autoritet por është shumë e rëndësishme që ne jemi të gjithë dhe jetojmë në një ombrelle, dhe kjo është shumë e rëndësishme. Znj.Seferi ishte personi parë që takova kur vajta në punë në datë 5 janar, u takuam rrugës dhe i uruam njëri tjetrit vitin e ri, kështuqë jetojmë të gjithë për respekt.

Znj. Mirela Koçi: Unë kisha vetëm një pyetje për Zv. Ministren e Drejtësisë duke qënë se ju përmëndët që jeni në fazën duke shtuar stafin që të mbarojë procesi, kur kemi patur takimin e fundit një përfaqësues nga Këshilli Lartë Gjyqësor na u tha që deadline qershor i 2025 që regjistri do ishte i përfunduar. Jemi në 2026 dhe a është e mundur të dimë të kemi një afat kur do të jetë, sepse është shumë kollaj për organizat që janë në Tiranë të shkojnë në Gjykatën e Tiranës brenda ditës, dhe të nesërmen e merr. Ne që jemi nga rrethet duhet të vijmë, të rrimë në Tiranë një natë, dhe këto janë kosto edhe për organizatën. Në këtë pikëpamje të krijon vështirësi, prandaj doja të dija nëse ka në planet tuaja një afat dhe pas kësaj doja të thoja dhe dicka tjetër, që ndoshta Ladi e harroi me cofinancimin.

Tedi Dobi: Dhe siç po thoja duke qënë se i tërë sistemi i gjyqësorit kishte nevojë për një rinovim, po bëhet pjesë e një moduli të madh i cili ka filluar implementimin që në shtator, dhe pritët që pjesa e parë që janë modulet e njofitmit, regjistrimit të mbarojnë në fund të 2026 dhe fillim të 2027. I tërë procesi i madh me të tërë pjesët e tjera, po që janë pjesë të brëndshme të gjykatës nuk është se ka shumë vlerë për publikun mbarojnë në dhjetor të 2027. Pjesa më kryesore njoftim dhe regjistrim të paktën me marrëveshjen nënkontraktore që ka kompania përkatëse me Këshillin e Lartë Gjyqësor këto janë afatet e parashikuara.

Znj. Mirela Koçi: Kërkesa e parë që kemi bërë në mbledhjen e parë të shoqërisë civile ka qënë regjistri elektronik. Ne duam të dijmë kush është situata, për ata që kontraktojnë apo nënkontraktojnë duhet të kenë një informacion siç ne futemi për çdo biznes dhe kontrollojmë gjendjen në QKB, të njëjtën gjë duhet ta kemi edhe për OFJ-të, pra na jep garanci dhe siguri edhe për parnteritet që lidhim, kjo është dhe një nga arsyet që unë këmbëngul për këtë. Në lidhje me tvsh doja të bëja një saktësim, duke qënë se jam në kontakt me Saspac, edhe me DG-REGIO i cili është enti që auditon Saspac dhe të gjitha projektet që financohen me fondet IPA ose nga programe të ndryshme, faktikisht certifikata e përjashtimit nga tvsh sot ofrohet për projektet, ofj që implementojnë projekte me autoritet kontraktues Delegacionin European Shqiperi ndërkohë që nuk ofrohet, kjo edhe për shkak të një rezistence nga Ministria e Financave, për të gjithë ofj-të përfituese të programit Interreg që janë të gjitha interreget, pra praktikisht arsyeja është tresholdi shumë i lartë që kanë në marrëveshjen kuader, 5 milionë euro, që asnjë nga përfituesit shqiptarë qofshin këto publik apo privat nuk e kanë treshold, por për institucionet publike Saspac e ofron këtë rimbursimin e tvsh-së për Ofj-të nuk e ofron, Ministria Financave nëpërmjet Saspac, i cili është enti që kryen pagesat. Kështuqë ky është problem kryesor, jemi në diskutime , ka një vullnet nga ana e Saspac për të gjetur modele në Maqedoni apo Mal të Zi, për të parë sesi mund të bëhet, fakt jemi që programi 2021-2027 IPA 3 është pothuajse në mes të tij për të mos thënë afër fundit për ato që janë projekte të thirrjes së parë pothuajse po mbyllen, që do të thotë kjo është kosto për organizatat, sepse paguajnë tvsh-në dhe nuk u njihet si shpenzim, dhe duhet ta mbulojnë nga fondet e tyre. Rëndohet akoma më tepër situata kur edhe pse është nënshkruar marrëveshja kuadër qeveria jonë e ka nënshkruar marrëveshjen kuadër, që për të gjithë përfituesit e programit Interreg do mbulojë co-financimin që shkon nga 15-20% për programet Interreg Europe për Ofj-të është 30%, e

vlerës totale të buxhetit. Edhe pse është e firmosur marrëveshja kuadër në gjithë këto vite nuk është respektuar, pra ne nuk jemi përfitues të fondit nacional të Co-financimit, e përfitojnë këtë fond vetëm institucionet publike, sërish ne jemi të diskriminuar. Të marrim një shembull, ne bëjmë rikonstruksionin e një shkolle, edhe me sistemin fotovoltaiik edhe me efikasitet energjitike dhe sigurisht unë dua ta bëj atë gjë se është komunitet, janë fëmijë por duhet të mendohet pesë herë sepse 20% e tvsh-së duhet ta mbuloj vetë, për të gjithë pjesën e rikonstruksionit apo të pajisjeve dhe cdo gjëje, pra kjo na kufizon edhe në tipologjinë e ndërhyrjeve që ne duam të bëjmë. Ne jemi agjenci zhvillimi dhe ne kemi bërë ndërhyrje në infrastrukturë, në objekte kulturore, në shkolla, në sera. Kam kolegen këtu që ka punuar paralelisht që janë sot SME shumë të suksesshme në Shqipëri, që janë krenaria jonë. Ideja është që nuk mund ta bëjmë pafund këtë, kemi propozuar një mekanizëm, unë kam qënë pjesë e grupit që ka udhëhequr anën fiskale, sugjerimet për përmirësimet fiskale për ojf-të dhe ne kemi dhënë sugjerim, siç është krijuar një fond garancie tek bankat për të mbështetur SME-të mund të krijohet një fond garancie për ojf-të për të mbuluar pjesën e Co financimit për të marrë fondin paraprak nga bankat me 0% interes, e ka Italia , e ka Greqia, e kanë të gjitha vendet Europiane, pse mos ta krijojmë dhe ne kur fondet janë, është mundësia që të bëhet dhe e ke të kontrolluar, sepse e gjithë përfaqësia auditimit i projekteve Interreg kalon tek Saspaku, pra është shteti që kontrollon të gjitha shpenzimet tona dhe i certifikon ato pra ka një garanci në këtë mes edhe për bankat që fondi do iu kthehet. Ky është një mekanizëm shumë i mirë në të gjitha termet qoftë në pikëpamje juridike qoftë si model financiar, ne mund ta sugjerojmë këtë gjë. Unë këto doja të thoja, sigurisht është edhe çështja e zhdoganimit, kur sjellim pajisje nga jashtë kemi shumë problem ligji, ligji parashikon përjashtimin nga taksa doganore për të gjitha pajisjet që vijnë të financiuara me fonde Europiane, nuk relaizohet kjo, ne na duhet tja kalojmë një SME dhe më pas SME tja dhurojë një institucionin. Është shumë e vështirë që të punohet në këtë mjedis, janë para që në fakt i hyjnë territorit. Ojf-të janë të aftë të shkruajnë projekte dhe shkruajnë projekte shumë të mira, përdorini si institucione publike për të marrë sa më shumë fonde.

Znj. Denada Seferi: Ta bëjmë më shkresë direkte nga Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile, por proceset e Interregut apo në proceset që mund të bëhet për zhdoganimin janë në riparje të të gjitha ligjeve, në riparje të gjitha dokumentacioneve që janë dhe akte ligjore, vendime, rregullatore që ndoshta duke u riadresuar dhe cuar me një shkresë zyrtare nga KKSHC, iku Andi por është Andia do duhen të dërgohen me shkresë zyrtare nga Këshilli.

Znj. Fabjola Egro: Faleminderit që ma dhatë fjalën prapë, sepse doja të isha pjesë meqë jemi dhe pjesë e këtij diskutimi të madh që po ngrejmë këtu. Unë si aktiviste e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të grave, dhe si aktiviste e shoqërisë civile prej tridhjetë vjetesh, sigurisht që e them se gjatë gjithë kësaj kohe nuk e kemi fushë me lule, aq më tepër që punoj për të drejtat e njeriut dhe jap shërbime si organizatë shërbime sociale dhe shërbimet janë gjithmonë halli i madh i cdo vendi , dhe jo vendi jonë si vendi i vogël me halle dhe relativisht i varfër por i çdo vendi, vendeve europiane me të cilët ne bashkëpunojmë dhe probleme shumë të mëdha ka

gjithmonë dhe unë nuk mund të them fjalën që e thotë Egla që ne kemi dështuar, unë në këtë Këshill Kombëtar të Shoqërisë Civile kam qënë për dy mandate me rradhë dhe e quaj pjesë të misionit tim, si shoqëri civile dhe si aktiviste sepse është një mënyrë për të shtyrë përpara të gjithë këto problematika që ne kemi jo për tia zbrazur juve por së bashku hap pas hapi ti realizojmë. Ka shumë të drejtë dhe kemi shumë të drejtë që problemin e regjistrimit elektronik apo problemin e madh të regjistrimit apo të cdo ndryshimi ashtu sic tha dhe Ergysi e kam dhe unë, kemi gjashtë muaj dhe akoma nuk na është realizuar. Sigurisht që ndikon, ne jetojmë me projekte dhe e dini çfarë do të thotë të jetosh me projekte si dhënës shërbimesh, ofrues shërbimesh, do të thotë që psikologu, avokati apo punonjësi social që shërben natë dhe ditë duke shërbyer për rastet, kur plasi ai rasti mediatik që ju e keni parë, nëna me tre fëmijë në Durrës, që nuk është absolutisht ashtu sic është paraqitur në media, psikologja apo avokatja që është e kontraktuar të më thotë që projekti ka mbaruar dhe unë nuk i përgjigjem atij rasti, pra ky është misioni jonë, misioni jonë që për sa kohë ka dhe 10 vjet që shërben dhe është ka përveç asaj që është profesioni dhe empatinë dhe forcën për ta vazhduar dhe për ti shërbyer atij rasti. Për Këshillin po flas dhe për ndryshimin e adresës në gjykatë që edhe kjo na pengon ne për të marrë projektin dhe për të qënë jo të saktë me donatorin, ne do jemi aty vullnetarë pavarësisht kësaj.

Do flasim për Këshillin dhe pse nuk e quaj unë jo dështim, sepse unë e mendoj që me gjithë këtë eksperiencë që kam puna është një rrugëtim i gjatë dhe ne këtu jemi për ta bërë këtë rrugëtim, për të ecur në këtë rrugëtim me të njëjtin hap, a kemi ecur në të njëjtin hap? Pse është anatemuar KKSHC sepse është parë gjithmonë është anatemuar vetëm për pjesën e shoqërisë civile që ne skemi bërë asgjë, që ne jemi bërë palë me qeverinë por KKSHC nuk është vetëm të zgjedhurit e shoqërisë civile, jeni dhe ju pjesa tjetër, dhe unë mendoj që hap pas hapi ne kemi ecur, sepse këto probleme që i themi me njëri tjetrin apo më poshtë ne i kemi sjellë këtu, çfarë duhet të bëjmë dhe kjo i mbetet anëtarëve të rinj është që a kemi krijuar dhe a është një mjedis mundësues për organizatat e shoqërisë civile, a e kemi këtë mjedis të lulëzuar, jo në këtë moment jo, a mundet meqë foli Tedi po flasim për kuadrin legjislativ të gjithë sistemit të organizatave të shoqërisë civile por edhe të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile. A duhet që ne të krijojmë një precedent dhe ta marrim këtë jo në kuadrin e të gjithë ndryshimeve që po bëni ju sepse tani ne e dimë që me integrimin në BE po bëhen shumë ndryshime bile edhe shumë ligje që po bëhen nuk po arrijmë dot edhe në pjesën e konsultimeve, kemi nesër përshëmbull për disa ndryshime për ligjin në konflikt me të miturit që ne kemi qënë një pjesë sëbashku që kemi punuar shumë vite dhe nuk arrijmë dot sepse do jemi këtu ose diku tjetër a mund ta marrim këtë si një paketë dhe kjo është një kërkesë që i bëhet KKSHC si një paketë për organizatat e shoqërisë civile për ti cuar përpara këto precedente që ne i kemi ngritur në vite, për tvsh, për kuadrin ligjor legjislativ, kemi thërritur këtu dhe Bankën e Shqipërisë që nuk e thamë këtu që ka një manual të vecantë antikorrupsion dhe kundër terrorizmit për oragnizat e shoqërisë civile, që ne na bllokojnë një herë në katër muaj nëqoftëse nuk cojmë të detajuar cdo gjë nëse na ka ndërruar një adresë ose ka ndryshuar

një anëtar bordi, ne na bllokojnë nuk presin komente dhe gjëra të tjera, që na bllokojnë dhe punën dhe nuk kemi përgjigje për donatorët.

Z. Vladimir Thano: Zonja Topalli nëse kishe dicka për të shtuar? Dhe ju lutem të vazhdojmë me axhendën.

Znj. Irena Topalli: Në fakt mund të futem direkt në axhendë. Një pyetje që kisha unë më parë Andi ia dha përgjigjen për grupin e punës dhe do ti referohem vetëm grupi të punës nuk do të hyj në diskutime. Unë jam anëtare e re dhe preferoj të dëgjoj më shumë, jo se nuk dëgjoj dhe nga jashtë se çfarë bëhet dhe çfarë ndodh në Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile. Mendoj që një fjalë e vetme që për mua ka rëndësi në procese dhe KKSHC-ja është një proces gjithashtu dhe nuk i thjeshtë, është fjala impakt, ne në shoqërinë civile preferojmë të lexojmë rezultate dhe më së shumti na pëlqejnë ato afatshkurtra, kur jemi në fushë edukimi e dimë që edukimi ka rezultate afatgjata që nuk maten aty për aty, jo për justifikim dhe nuk kam nevojë ta bëj me askënd por mendoj që KKSHC në vetvete si proces dhe mekanizëm i përket më shumë një procesi i cili rezultatet i nxjerr në afatgjatë por nga ana tjetër unë jam e lumtur që në fund të ditës vij në KKSHC pas mandateve të kolegëve të mi që kemi dy dekada të paktën që bashkëpunojmë të cilët mirë apo keq, çfarëdo qoftë njesia matëse e kanë bërë punën e tyre dhe jam dakort edhe me zonjën Egro për pjesën e fundit por jam dakort edhe me Eglen për pjesën autokritikën e të pasurit ose jo sukses. Unë suksesin do të dëshiroja ta matja me impakt por duke i vënë emrin atij impakti dhe mendoj që grupi i punës është ajo çfarë na i bën, dhe për ti rënë shkurt kësaj pjesës pyetja juaj e parë Ladi ishte se kush është i gatshëm të marrë pjesë në grupin e punës, ne anëtarët e rinj, nuk e di nëse kolegët që kam përballë janë ok me këtë edhe Blerta gjithashtu. Nuk kemi fare presion pas gjithë këtyre diskutimeve, hiç fare por unë jam e gatshme të kontribuoj në grupin e punës, nëse ky është hapi i parë dhe jam e gatshme gjithashtu edhe të mbështes edhe propozimet e mëparshme që në këtë grup pune do të ishte shumë mirë që të kishte anëtarë të cilëve po u mbaron mandate, nëse ka një formë lijqore brenda KKSHC-së për ta mbajtur po sepse njohuritë institucionale, eksperiencia institucionale e këtij institucioni më vete është shumë e rëndësishme edhe për ne të rinjtë. Ne duam, unë të paktën për ta bërë personale, dua të vazhdoj mbi hapat e atyre që kanë kontribuar për disa mandate në cilëndo formë qoftë ajo për ti ngritur çështjet dhe për ti çuar aty dhe për të bërë mundësisht ato gjërat që nuk janë bërë deri më sot, në bashkëpunim me institucionet publike. Në procesin e integritetit ne të shoqërisë civile kryesisht quhemi ‘non state actors’ nuk quhemi as shoqëri civile, kështuqë edhe në terminologji ndonjëherë ne nuk e dimë se ku gjendemi por thjesht fakti që e kemi hapësirën për ta bërë këtë dialogun në këtë platformën më të hapur me state actors dhe non state actors le të nisim këtë grupin e punës si gjë të parë dhe të shtyjme dhe të vazhdojmë procesin ndoshta më aktiv ndoshta dhe ne në fund të katër vjeçarit tre vjeçarit sdo kemi sukses por ishalla do kemi, por do vendosim piketat si do ta masim.

Z. Indrit Seferi: Do doja të falenderoja së pari të gjithë kolegët për punën e bërë në gjithë këto vite që kemi ndërvepruar sëbashku, po ashtu dhe pjesë që ka qënë prezent dhe nga pala tjetër e përfaqësuesve të minsitrive. Unë do isha personalisht diku në mes përta i përket arritjeve,

është e vërtetë dhe bashkohem me kolegun Ergysin që praktikisht puna që është bërë duhet të matet, dhe ajo matje e punës së procesit duhet të vijë si rezultat e para si proces e një reflektimi të institucioneve publike që janë përfaqësues këtu dhe nga ana tjetër të koordinuar dhe me sekretariatit e AMSHC-së që duhet ta paraqisnin sepse duket sikur ne që jemi këtu në rolin e Këshilltarit duhet të bëjmë disa procese njëkohësisht, ndërkohë që ajo për cka ne jemi të mandatuar jemi për të dhënë opinione, mendime, këshillat e kolegëve të cilët jemi të përfaqësuar këtu, pra duhet të kuptojmë saktë të drejtat dhe detyrimet që kemi që të mos ngatërrojmë rolet, kjo është e para .

Së dyti, do doja të kishte një linjë vazhdimësie përsa i përket të gjithë procesit të KKSHC-së edhe në mandatet e tjera, sugjeroj që ato kolegë që kanë dëshirë të jenë aktiv sërish dhe nuk janë të mandatuar dhe kanë dëshirë të jenë pjesë e grupit të punës në mënyrë të vazhdueshme. Patjetër që fuqizimi i këtij organi është proces, nuk mund të pretendojmë mrekullira, sfidat janë të shumta në çdo drejtim, patjetër që ne jemi këtu dhe përfaqësojmë shoqërinë civile dhe krijojmë një mjedis mundësues me ato mundësi që kemi por jo nuk mund të arrihet vetëm nga ne, duhet dhe përfaqësuesit e ministrive të jenë më aktiv me rezultate konkrete. Një sugjerim që unë e kam thënë që në fillim dhe praktikisht duhet të realizohet të paktën me kolegët e tjerë që do vijnë duhet që të ngrihen ekipe pune dhe brenda linjave të ministrisë. Unë përshembull që flas punoj në sektorin e shëndetësisë dhe jam thërritur shumë pak në tryeza konsultimi përsa i përket politikave që lidhen me fushën e shëndetësisë. Secili prej nesh këtu është një ekspert i fushës, dikush i të drejtave të njeriut, dikush nga drejtësia, dikush nga mjedisi, duhet të kemi tryeza sa më shumë dhe këto tryeza duhet të reflektohen sepse problemet që ne shohim është mungesa e reflektimit të kësaj pune. Unë të paktën nga eksperiencia që kam pothuajse dy mandate, patjetër kemi qënë përpara sfidave si tërmeti, pandemi dhe në të shëndetësisë e kemi ndjerë pak më shumë por çështja është që duhen ato rezultatet e matshme në fund të ditës, si për ju në institucionet ku jeni si për ne në ato shoqatat ku operojmë por edhe në rrjetet , dhe duhet që dhe ju nga ana e ministrive përkatëse ti drejtoni këto të dhëna afarë janë arritur, afarë sjanë arritur apo dhe ato që janë arritur në rrugëtim të mesëm duhen reflektuar. Unë këto kisha, faleminderit.

Z. Vladimir Thano: Faleminderit Z. Seferi. une mendoj që kemi kaluar dhe tejkaluar në fakt orarin por kjo është edhe në të mirë të autoriteteve publike që të kuptojnë më mirë sistemin e shoqërisë civile dhe ato që kanë përballë, në mbledhjen e ardhshme do të kemi natyrisht edhe zhvillime të tjera, kështuqë dakort mbi zgjedhjen e anëtarëve të rinj të KKSHC-së mandati mbaron në shkurt të 2026 siç e tha dhe Andia, do të ketë një proces votimi, do ngrihet një komision i cili do të vlersojë të gjithë procesin siç ka ndodhur , mund të komunikohet me email dhe të shikojmë dakortësinë. Për hartimin e kalendarit të aktiviteteve znj. Topalli tha që dhe anëtarët e rinj nëse janë dakort, të ngrejne dorën, ndërkohë që nga anëtarët e vjetër të shoqërisë civile që nuk i ka mbaruar mandati për mendimin tim duhet të vazhdojnë të qenurit anëtar, Egladjo jesh edhe për pak kohë .

Z. Ergys Gezka: Ne patjetër që do ta vazhdojmë, çështja është vetëm një përgjigje drejtuar Znj. Seferi. Unë mendoj që nuk duhet ta shtrojmë në palni anëtarë të nderuar apo më pak të nderuar, ne e dimë që të gjithë janë të nderuar.

Znj. Denada Seferi: Çfarë lidhje ka kjo?

Z. Ergys Gezka: Sepse thatë në fjalën tuaj që përfaqësuesit e qeverisë janë anëtarë të nderuar, ne nuk thamë të kundërtën.

Fabjola Egro: Gysi të lutem ka mundësi të mos kapemi pas fjalëve dhe të flasim për thelbin se nuk na ka thënë njeri që nuk jemi të nderuar.

Z. Ergys Gezka: Në qoftëse ju do të vazhdoni të mbivendoseni nuk do të merremi vesh, ne nuk jemi kundër ne jemi bashkëpunues por fjala na nxirrte shumë keq.

Znj. Denada Seferi: Nuk të lë të flasësh, partneritetin dhe bashkëpunim që ne kemi me ju është shumë i rëndësishëm, dhe po të siguroj për këtë.

Z. Ergys Gezka: Ne jemi këtu prezent, këtu ka drejtor drejtorish që janë prezent si e thotë ligji i KKSHC-së dhe nëse institucioni nuk respekton ligjin unë unë jam i detyruar të mos ju lejoj juve të mbivendoseni mbi zërin tim si shoqëri civile për të vazhduar për të folur. Atëherë ne jemi këtu dhe nuk paguhemi, është zgjedhje, vazhdojmë të jemi dhe pse ka mbaruar mandate, nga ana tjetër pretendojmë pak më tepër respekt për shoqërinë civile dhe të mos bëjmë retorika shterpe të nderuar të pa nderuar dhe pse pastaj aderohet shoqëria civile. Nuk ka pse të aderohet, jemi ne të aderuar. Ajo që unë thashë dhe e përsëris nuk ka nevojë për dështime apo suksese, raport publikoni raport nëqoftëse raporti do të përmbajë vetëm u munduam të bënim këtë gjë, u munduam ta adresojmë atëherë le të kuptohet nga e gjithë njerëzia këtu nga insiticionet dhe nga qytetarët se çfarë është bërë dhe cfarë nuk është bërë. Thënë këtë është e rëndësishme të mos e spetojmë diskursin në nivele që nuk i takojnë kësaj tryeze.

Znj. Denada Seferi: Faleminderit shumë, ne e vlerësojmë shumë dhe e kemi vlerësuar çdo ditë kontributin që keni dhënë dhe kontributin që japim të gjithë ne. Në këtë bisedë nuk mund të ketë asnjë lloj retorike dhe asnjë përgjigje nga ana ime, më vjen shumë keq por nuk mund ta ul nivelin e bisedës së këtij Këshilli Kombëtar të Shoqërisë Civile për çështje të cilat nuk kanë të bëjnë me rendin e ditës. Shumë faleminderit.

Z. Vladimir Thano: Ju faleminderit, besoj se brenda marsit duhet të kemi një mbledhje të ardhshme.

Znj. Denada Seferi: Patjetër Patjetër.